

# KUVENDI

## QARKU KUKËS

### **Arbjan Mazniku:**

Të bëjmë seancën e dytë të gjestrave, e cila, në fakt, vjen e dyta pas një seance të parë, pas një fakti.

Problemesh në fillim të saj, besoj se arritën në një modalitet shumë të mirë funksional pune, dhe doja që, kam vënë re dhe që ka pasur vëmendje goxha të lartë nga ana e publikut për ta ndjekur në transmetimet live dhe nga mediat, por edhe në faqen e parlamentit. Ndaj dhe do isha shumë i lumtur nëse do të vazhdonim me të njëjtin mekanizëm funksionimi pune, që t'i japim mundësi kryetarëve të bashkisë për ato tema të cilat tashmë janë tema publike dhe me rëndësi për qytetarët e vendit, veçanërisht për qarkun e Kukësit, kryetarët e bashkive respektive. Siç ju jeni ndjeni, temat tona kryesore të interesit lidhen me tre kategori kryesore. Kategoria e parë lidhet me kompetencat që ligji 139 i jep bashkive, për qartësinë e këtyre kompetencave, për mënyrën dhe kapacitetin tuaj për t'i zbatuar këto kompetenca për problematikat që mund të ketë me to, kush është më e ngarkuar, kush është më e lehtë. Kategoria e dytë lidhet me financat vendore dhe me mbulimin financiar si nga të ardhurat e vetë bashkive, ashtu edhe nga të ardhurat e grantit të qeverisë, dhe mënyrat si mund të përmirësohen financat vendore, si mund të forcohet autonomia vendore, si mund të përmirësohet mundësia për të ofruar shërbime. Elementi i tretë lidhet me territorin, dhe qeverisjen e territorit, dhe mënyrën si funksionon kjo çështje. Rreth këtyre tre kategorive të temave, protokolli i funksionimit që kemi është që deputetët bëjnë një apo disa pyetje. Pyetjet mund të jenë për të gjithë kryetarët, mund të jenë për dikë prej kryetarëve. Kemi dakordësuar që, në varësi të pyetjeve, të kemi dy minuta për përgjigje për çdo kryetar. Në qoftë se ka pyetje komplekse me disa pyetje, jam dakord që të kemi edhe raste që t'i bëjmë tre minuta përgjigje, por duke e bërë në këtë mënyrë kemi mundësi që të strukturojmë në mënyrë sistematike mundësinë dhe t'i japim kohë të gjithë kryetarëve të shprehën, por edhe deputetëve të bëjnë pyetjet që duhet të bëjnë. Kështu që, duke qenë shumë i interesuar për të dëgjuar përgjigjet e secilit prej jush, do të doja që të fillojmë këtë mbledhje dhe t'ia jap fjalën bashkëkryetarit.

### **Luçiano Boçi:**

Ju uroj mirëseardhjen kryetarëve të bashkisë së qarkut të Kukës. Elbasani ka pasur interes. Madje në Elbasan ne kemi ezauruar dhe dëgjesën në rang qarku, dhe meqenëse me Kukësin kemi specifikë tjetër, pretendoj që interesi i publikut do të jetë akoma më i madh për atë çka ju do të shprehni, pavarësisht se ne, në mënyrë të pavarur nga komisioni, kemi realizuar një dëgjesë me bashkinë e Hasit, ku është kërkuar qëndrimi i kësaj bashkie si bashki më vete. Po, do të përqendrohemi në tre kolonat kryesore ku insiston reforma territoriale, por krahas kompetencave duhet të përqendrohemi tek funksionaliteti, sepse në dëgjesat që kemi bërë, por edhe në opinionet që kanë dhënë kryetarët e bashkive përgjatë këtyre dëgjesave, ka një mospërputhje midis funksioneve që ata shohin në ligjin organik dhe kompetencave që kanë në dispozicion bashkitë për realizimin e këtyre funksioneve, ose nuk kanë mjetet e tjera, qofshin këto mjete financiare apo elementë tjerë që ndihmojnë në realizimin e këtyre funksioneve. Patjetër pastaj, tema më e nxehtë, tema kryesore do të thoja unë, jo se është qëllimësia jonë parësore, por është e natyrshme, është çështja e territorit. Çdo gjë është e lidhur me territorin: funksionaliteti, kompetencat, shërbimet, përfaqësimi, autonomia, demokracia janë të

lidhura me territorin. Dhe këtu do na duhet që kryetarët e bashkive të jenë më të shprehur, më konkretë në raport me territorin që mbulojnë, me territorin që mendojnë ata se duhet të mbulojnë në të ardhmen, të qëndrojnë apo të ndahen. Dhe shprehja e tyre dhe qëndrimi i tyre është shumë bazik për atë çka presin qytetarët, sidomos ata qytetarë që sot nuk marrin të njëjtin nivel shërbimi sikurse të tjerët që janë më afër qendrës. Kjo nuk ndodh vetëm në qarkun e Kukësit. Ky fenomen është fenomen mbarëshqiptar, ndodh në të gjitha bashkitë ku është evidentuar jo nga opozita thjesht, jo vetëm nga qytetarët konkretisht, por edhe nga raportet ndërkombëtare që ka një diskriminim shumë të madh brenda vetë bashkive, qofshin këto të vogla, mesatarisht të mëdha apo të mëdha, sikurse ka diskriminim ndërmjet bashkive të mëdha dhe bashkive të vogla, kjo sepse edhe starti nuk ishte i barabartë. Madje SIGMA përcakton që diferencat ekonomike ndërmjet bashkive janë në Shqipëri më të mëdha se në çdo shtet tjetër. Prandaj ne e konsiderojmë shumë të vlefshme këtë dëgjese me kryetarët e bashkive. Ka qenë një iniciativë e grupit tonë parlamentar, e pjesës sonë të përfaqësimit në këtë komision, që dëgjesat të zhvillohen krahas dëgjesave me qytetarët apo me grupet e interesit, të realizohen edhe realisht me kryetarët e bashkive, sepse tek e fundit, siç është qytetari që merr shërbimin dhe e di shumë mirë si i shkon shërbimi, ka dhe një anë tjetër, një faktor tjetër që transmeton dhe jep shërbimin, dhe kjo është bashkia. Dhe janë këto dy elementë, dy palë që e dinë shumë mirë dhe cilësinë dhe përfaqësimin dhe çështjet e kompetencave apo çështjet e funksionalitetit. Prandaj unë mendoj që pa vonesë të nisim nga pyetjet, meqenëse zoti Nallbati e ka kërkuar i pari fjalën, ia kaloj atij fjalën.

#### **Bledion Nallbati:**

Faleminderit. Përshëndetje të nderuar kryetarë të bashkive, faleminderit për prezencën tuaj këtu. Vijmë në këtë komision. Mbas 11 apo 12 viteve të reformës së viteve të vitit 2014, reformës administrative territoriale, dhe ka një diskutim të gjerë ku ka 2 opinione apo 2 mendësi. Ne si opozitë që themi që kjo reformë ka qenë një reformë e paplotë, e bazuar mbi kalkulime elektorale dhe jo mbi interesin qytetar, dhe si e tillë ka prodhuar në këto vite një sërë anomalish dhe problematikash në raport me shërbimet dhe me cilësinë e këtyre shërbimeve që duhet të marrin qytetarët. Dhe kemi palën tjetër e cila thotë që ka qenë një sukses, një histori sukcesi. Që ka ofruar, ka prodhuar bashki më të forta dhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve. E gjithësesi, edhe pse e shprehu në mënyrë të tillë nga mazhoranca, vijmë prapë, detyrohemi të vijmë për ta riparë këtë reformë. Si njerëz që jeni të zgjedhur nga qytetarët, që keni detyrim të drejtpërdrejtë ndaj qytetarëve tuaj, sepse sot, për mënyrën se si funksionon Shqipëria, zgjedhjet në Shqipëri, i vetmi person i zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë dhe me vullnet drejtpërdrejtë nga qytetari është kryetari i bashkisë. Do doja të di opinionin tuaj, po nëpërmjet jush, edhe opinionin e qytetarëve që ju përfaqësoni, të cilët ju kanë votuar dhe të cilëve ju keni një detyrim politik moral për të qenë të vërtetë dhe për të dhënë këtu opinione të drejta, jo opinione politike, por opinione të drejtpërdrejta, të cilat mendoni që do t'i shërbejnë këtij komisioni. Në mënyrë që të hartojmë tashmë një reformë, jo si ajo e vitit 2014, e bërë nga vetëm njëra palë politike, e cila mendoi dhe skicoi një reformë politike dhe jo një reformë administrative territoriale. Dhe pyetjet e mia janë të thjeshta e të drejtpërdrejta. A mendoni ju që reforma e 2014-ës së 1-ri ka pasur problematika të theksuara për sa i përket çështjes së ofrimit të shërbimeve më afër dhe më cilësore ndaj qytetarit? Besoj e keni ndjekur debatin e bërë publik nëpër media apo edhe në komisione gjatë gjithë kësaj kohe, ku shpeshherë nga përfaqësuesit e mazhorancës flitet për një aspekt: performanca ekonomike e bashkive. Dhe konsiderohen institucionet e bashkisë si kompani private biznesi. Dhe meqenëse një pjesë e tyre kanë detyrime apo kanë borxhe, do të duhet që sipas mazhorancës të shkrijnë dhe të bashkohen në bashki më të mëdhaja. Por nëse do

të ecnim në fakt në këtë logjikë, çdo shtet e çdo qeveri ka detyrime, përfshirë të parin shtetin shqiptar që ka borxhe të mëdha, dhe në këtë koncept, në këtë logjikë do të duhej ta shkrinim qeverinë shqiptare t'ia jepnim asaj suedeze, për shembull. Po po e le këtë retorikën dhe po ju pyes: a mendoni që ka qenë e suksesshme apo ka pasur problematika? E 2-ta, a mendoni ju që numri i bashkive apo territoret të cilat ju përfaqësoni konkretisht ju në qarkun e Kukësit duhet të qëndrojnë kështu siç janë? Duhet të shkrijnë dhe të bashkohen me njëra-tjetrën, apo duhet të ndahen në territore më të vogla, gjithmonë me synimin për të qenë sa më pranë qytetarëve, me shërbime sa më cilësore dhe në kohë sa më të shkurtër? A mendoni ju që do t'i vlente dhe do ishte më mirë, po themi, për bashkinë e Tropojës që të shkrijë dhe të bashkohet me Kukësin dhe taksa dhe tarifën e këtyre qytetarëve, apo qoftë edhe Hasi, taksa dhe tarifën e këtyre qytetarëve që paguajnë këta njerëz do të administroheshin më mirë nga bashkia tashmë e madhe e Kukësit dhe do të shkonin dhe do të përktheheshin në shërbime më të mira për qytetarët e Tropojës dhe të Hasit, apo kështu siç janë sot? Apo në qoftë se do të menaxhoheshin edhe në njësi akoma më të vogla? Dhe ne kemi për shembull rastin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, një provë, një test të bërë nga qeveria, e cila u hoqi bashkive një nga funksionet më bazike, më të rëndësishme që kanë bashkitë: furnizimi me ujë të pijshëm, për të cilën çdo kryetar bashkie përballet çdo ditë me qytetarë për çështjet e këtyre problematikave. Ua hoqi këtë kompetencë, ua dha qeverisjes qendrore, duke i lënë me kuota brenda këtyre shoqërive të mëdhaja, por pa asnjë lloj kompetence dhe mundësie për vendimmarrje mbi këto shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve. A qe ky një shembull i mirë dhe duhet të ecim në këtë shembull? Apo duhet të ecim, duhet të qëndrojmë në këtu ku jemi si territore, apo duhet të shikojmë një reformë duke e rritur numrin e bashkive, duke ulur deri diku numrin e territoreve përshtatur me gjeografinë, kulturën, historinë e këtyre zonave dhe duke forcuar kompetencat e këtyre bashkive dhe financat e këtyre bashkive? Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Në vijim të procesit kemi caktuar një kohë prej 2 minutash për çdo kryetar për t'u përgjigjur, sigurisht me një tolerancë të vogël në varësi të pyetjes, po besoj se shkohet mjaftueshëm. Do i lutesha me shumë mirësjellje të gjithë anëtarëve të komisionit që në vijimësi të tentojmë t'i mbajmë pyetjet pa shumë parashtrim, për të mos harxhuar ne kohë, por për t'i dhënë kohë kryetarëve për t'u shprehur, se ne do kemi gjithë mundësinë, e kemi pasur mundësinë ta bëjmë këtë diskutim dhe nëse harxhojmë ne 10 minuta dhe 2 minuta ja japim kryetarëve, më duket që është pak e padrejtë. Faleminderit.

### **Albert Halilaj:**

Përshëndetje të gjithëve. Duhet të falenderoj bashkëkryetarët dhe anëtarët e këtij komisioni për reformën administrative. Është një problematikë, një temë e cila prek gjithë qytetarët e çdo rajoni të shtetit shqiptar. Në lidhje me qarkun e Kukësit, me pyetjet që bëri deputeti, unë do t'i jap një përgjigje koncize dhe shumë të shkurtër. Reforma territoriale që është implementuar në vitin 2015 është me gjithë komponentët dhe ka në fokus shërbimin ndaj qytetarëve. Në qoftë se bashkia e Kukës ka qenë e fokusuar në shërbimet vetëm në qytet, me ndarjen e territoriale, janë shtuar edhe 14 njësi administrative, të cilat janë në fokus për në lidhje me shërbimin e unifikuar të mbrojtjes nga zjarri, për shërbimet publike, ndriçimin, pastrimin, menaxhimin e mbetjeve e shumë e shumë problematika që ka territori. Por dua të them në lidhje me pyetjen e 1-rë, e cila përcjell deputeti për shqyrtim, cila ka të bëjë me fokusin e shërbimeve, nëse është më mirë aktualisht ose nëse do performonte më mirë me ndryshimin e reformës territoriale. Unë them që fokusi është i përqendruar nga strukturat e bashkisë dhe është shumë mirë në lidhje me shërbimet

publike. Në lidhje me pyetjen e 2-të, e cila përcjell mesazhin nëse duhet të shkrijnë ose duhet të bashkohen, ato aktualisht, siç janë bashkitë në qarkun e Kukësit, janë të përfaqësuara densisht si për territorin, si për traditat, si për zakonet. Secili bashki ka të veçantat e saja. Dhe besoj që është shumë mirë po të jetë me të njëjtën ndarje territoriale, e cila është e implementuar në vitin 2015. Në lidhje me menaxhimin e taksave, meqenëse kam punuar edhe shumë kohë unë me tatimet, besoj ka nevojë për përmirësime, por realisht në lidhje edhe me strukturën, me këtë implementim të kësaj reforme, ka benefite, por ka edhe problematika. Një ndër problematikat, jo vetëm në qarkun e Kukësit, por besoj edhe në shumë qarqe të tjera, për bashki të vogla flas, është dixhitalizimi i bashkive. Në qoftë se, për shembull, do të jetë sistemi i taksave në Hasë, Kukës dhe Tropojë me një sistem, është shumë më mirë dhe shumë më eficient për menaxhimin e taksave dhe për rritjen e tyre vit pas viti. Në lidhje me problematika tjera që ka aktualisht kjo ndarje territoriale, ka të bëjë me regjistrimin e pronave dhe planeve vendore që bashkia e Kukësit, po flas për Kukësin, ka një sërë pronash që jemi në bashkëpunim të ngushtë me ASHK-në për t'i regjistruar në kohë, por ka shumë shumë sipërfaqe që nuk janë të regjistruara dhe nuk janë të përfshira në planet vendore që ka bashkia. Besoj që zgjidhja më optimale për këtë ndarje territoriale që është aktualisht në fuqi është decentralizimi financiar i çdo bashkie për të mbuluar detyrimet e prapambetura, të cilat kanë qenë nga një ish-njësitë administrative që janë transferuar bashkisë së madhe. Edhe përmirësimi i infrastrukturës rurale, kryesisht në njësitë administrative, e cila do të ketë një impakt në lidhje me edhe me zhvillimin e turizmit, edhe në lidhje me zhvillimin ekonomik të zonës, duke gjeneruar të ardhura. Kjo përfshin edhe paketën e maleve dhe shumë investime të tjera që priten të implementohen në zonë. Ju falenderoj për përgjigjen.

#### **Arbjan Mazniku:**

T'i japim fjalën kryetarëve të tjerë, zoti myftar. Do t'i japim fjalën myftarit për kështu, për përshtatje, zoti Biberi, t'i japim fjalën myftarit për.

#### **Rexhë Byberi:**

Dhe sinqerisht, sinqerisht jam i kënaqur që diskutohen këto probleme, se gjithë bota janë në interes të komuniteteve tona që ne shërbejmë atje dhe jena kryeshërbëtorë të atyre bashkive. Unë marr shkak nga përvoja ime që kam qenë edhe kryetar komune. Dhe kur deshini mu shkrinë këto komuna, ne e kemi qenë pothuajse kundër, faktikisht. Tani, si erdhi koha, e provuam se çfarë në çfarë shtate jemi. Unë pe e provova edhe si kryetar bashkie. Jo pa qëllim e thashë se do kisha dëshirë, siç jeni këtu, të ishim në Tropojë. Dhe ta shihni Tropojën para 2019, se ta shihni edhe sot, ku me 80% të buxhetit të bashkisë, sot Tropoja ka ndryshuar. Në gjithçka. Shërbimet pothuajse janë shtrirë në të gjithë rrethin e Tropojës, pavarësisht se bashkia e Tropojës në sipërfaqe është më e madhe në Shqipëri, duke lënë Tiranën. Dhe në një pozicion gjeografik jo të përshtatshëm, shumë të vështirë, ku shërbimet tani kërkohen edhe në majat rreth 2000 mbi nivelin e detit, sepse e mban të qarkullueshme makinë gjithë atë trojet e malësisë së Gjakovës. Po kështu, nuk u shërbej ke as në kanalet vaditëse. Sot, mbi 80% e kanaleve vaditëse janë në funksion të qytetarëve të Tropojës. Problemet që na shqetësojnë ne në marrëdhëniet me shërbimet ndaj qytetarëve, kemi probleme me kadastrën, me thënë të drejtën, sepse çdo shërbim duhet të shkojë të merret në Kukës. Ose edhe kualidimi i makinave do ishte shumë pozitiv që të kthehet në Tropojë dhe qytetarët të merrnin këtë shërbim në Tropojë. Kurse për sa i përket shërbimit, ka një pozitivitet, me të thënë të drejtën, është sepse kam qenë kryetar komune, nuk vetë nuk kryesha asnjë funksion pothuajse. Nuk gjasha 1 inxhinier që ta marr në punë. Sot, për shembull, vetëm tek midisi kam 5 inxhinierë që me ndryshimin e pagave kanë arritur që të ofrohen të punojnë në Tropojë. Sot kam nga drejtorinë e urbanistikës, si

nuk gjesha njeri, sot kanë ardhur inxhinierë të punojnë në Tropojë. Sot në bashkinë e Tropojës janë punësuar mbi 83 në administratën e asaj bashkie në profesione të ndryshme. Dhe jo pa qëllim e them me shpirt, nuk e them asnjë krah se 2 krahët më punojnë. Po më punojnë gjithmonë për Tropojën e timen të dashur dhe jam shumë krenar që ata njerëz më kanë zgjedhur shërbëtor të tyre. Dhe kisha dëshirë një ditë t'ju ftoj të gjithëve edhe në qytetin e Barançurit të bukur, një qytet me histori, Valbonën turistike, vetë kështu që të jemi, të gëzojmë, të festojmë. Dhe të marrim edhe opinionin e publikut. Nuk kam më gjë tjetër. Kisha edhe një dëshirë, nderuar kryetar, ne paguajmë sigurimin shoqëror, të gjithë ata punonjës që janë në Tropojë.

### **Arbjan Mazniku:**

Do kalojmë, do kalojmë te çështjet, t'i qëndrojmë pyetjeve që ka zoti Albati. Sot do rikthehem prapë.

### **Rexhë Byberi:**

Ata të ardhura të ishin kthyer një pjesë, një pjesë edhe të me qenë ata banorë në Tropojë ose në rrethe të tjera, mos vinin tani në qeveri. Madhe më falni, atëherë faleminderit prej jush.

### **Miftar Dauti:**

Edhe përshëndetje bashkëkryetarë, përshëndetje anëtarë të komisionit. Sigurisht që sot jemi në këtë takim si kryetar bashkish për të diskutuar bashkë me ju për ndarjen e re territoriale. 1 ndarje e cila është bërë qysh në vitin 2014 dhe sipas gjitha gjasave ka nevojë për përmirësime. Pasi nuk ka shkuar gjithçka mirë në shërbim të qytetarit. Sipas mendimit tim, sipas pyetjeve të deputetit, unë jam kryetar bashkie për mandat të 1-rë. Dhe mendojmë që jemi munduar me ato kompetenca që kemi t'i gjendemi sa më afër qytetarëve me shërbime. Nga ana e ndarjes territoriale, besoj që qarku i Kukësit ka identitetin e vet. Janë 3 rrethe, 3 bashki. Dhe mendoj që kjo ndarje i përshtatet qarkut të Kukësit. Aq më tepër që ne si bashki Hasi ka identitetin e vet. Ka qenë perfektuar qysh më herët. Ka pasur internatin Kosova që kanë nxjerrë shumë koka që kanë qeverisur shqiptarinë. Dhe mendoj që nga ana e territoriale, ndarja është e drejtë. Kurse për pjesën e shërbimeve, mendoj që në kuadër të kësaj reforme territoriale duhet të shikohet me përparësi decentralizimi i pushtetit, dhënia e kompetencave të kryetarëve të bashkive, pasi ne jemi zgjedhur dhe çdo shërbim qytetarët pikësepari drejtohen te ne në një kohë kur ne shumë institucione nuk i kemi në varësi. Dhe nuk jemi, nuk jemi kompetentë që t'ju zgjidhim problemet e tyre. Kështu që mendoj që ky komision do gjejë mënyra të duhura që bashkitë ti forcojnë edhe nga ana financiare me taksat, me kompetencat që do jepen në lidhje me detyrimeve, taksave dhe tarifave të ndryshme. Kështu që unë mendoj që për qarkun e Kukësit, po them edhe njëherë, ndarja është e saktë dhe pjesa tjetër pastaj ne do diskutojmë edhe për gjëra të tjera që ne mund të japim mendimet tona. Faleminderit.

### **Bledion Nallbati:**

Faleminderit. Po, drejt në koment në fillim sa thuash, po hajde s'ka ardhur. Shiko, i dëgjova kryetarët, faleminderit në kryetar i Kukësit edhe i Hasit ishin më të drejtpërdrejtë në përgjigjen e tyre. Kryetari i Tropojës, si lojtari i vjetër, u kujdes që mishin ta pjekë e errën, mos ta djegë. Nuk më dha një përgjigje drejtpërdrejtë. Tropoja duhet të qëndrojë kështu siç është. Duhet të shkrihet me Kukësin. A duhet ndarë në njësinë më të vogla? Të drejtpërdrejtë është, lutem, kryetar, të drejtpërdrejtë është, lutem, dhe në mikrofon.

### **Rexhë Byberi:**

Do qëndrojnë kështu siç është.

Vetë, vetë, vetë, vetë në bashkë bashkëkryetar me kryetarin e Hasit.

Tropoja është në njësitë më të mëdha të republikës, kështu që besoj që i plotëson kushtet që të jetë një njësi e veçantë.

### **Etleva Budini:**

Përshëndetje dhe mirë se keni ardhur në këtë degëzë në komisionin tonë. Si deputete, por edhe si pjesë e këtij komisioni, sigurisht jam e interesuar shumë për nivelin dhe cilësinë e shërbimeve që ofrojnë bashkitë tuaja. Kështu që pyetja ime është shumë konkrete: çfarë shërbimesh ofrojnë bashkitë tuaja pas reformës territoriale të 2014-s në cilësi të mirë, por edhe shërbime që nuk i ofronin më parë komunat ose i ofronin me një cilësi jo aq të mirë? Dhe ana e sjellta: a ka shërbime që i ofronin më parë komunat edhe në cilësi të mirë, dhe sot nga bashkia nuk është e njëjta cilësi i ofrimi, ose po themi mund të ketë dhe që nuk ofrohen fare për shkaqe të ndryshme? Për shembull, një shkak mund të jetë dhe shtrirja gjeografike. Faleminderit.

### **Albert Halilaj:**

Faleminderit për pyetjen. Në lidhje me 2 shërbimet kryesore që performon më mirë bashkia aktualisht me ndarjen e re administrative, është shërbimi i zjarrfikës, i cili, përveçse bashkisë së Kukës, mbulon edhe njësitë administrative dhe jam munduar që vit pas viti të investojmë në shërbimin e zjarrfikësit, duke i plotësuar edhe me elementë të cilët e kanë domosdoshëm për të kryer punën e tyre. Por edhe shërbime të tjera që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dimërore, po ashtu edhe shërbimin e pastrimit, i cili ka qenë funksional vetëm në bashkinë e Kukësit në qytet dhe është rritur shërbimi njëherë në javë në çdo njësi administrative, duke bërë të mundur edhe shërbimin në kohë nëpërmjet pastrimit, ndriçimit në njësitë administrative kryesore. Nevoja ka për përmirësim sa të duash, por ngelem atë faktin e 1-rë që bashkitë duhet të mbështeten nëpërmjet financave, duke mbuluar ato bashki që kanë nivel të ulët aktivesh nëpërmjet taksave. Që realisht Kukësi është 10-12% të gjithë targave që krijon, edhe besoj që jemi për të shërbyer qytetarëve, por realisht duhet mbështetje në infrastrukturën rrugore. Kjo kryesisht nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në zonat e thella malore, të cilat është e pamundur që të ndërhyret me fondet e bashkisë. Faleminderit.

### **Rexhë Byberi:**

Siç theksoi edhe kryetari i Kukësit, edhe në shërbimin parësor e kemi me shërbime ndaj qytetarëve, që është pastrimi i qytetit dhe njësi administrative që gjë e rasin, me të thënë të drejtën, janë shumë pozitive. Kur ne kemi qenë në njësi komune, nuk kemi pasur as mjet, as gjë mbi këtë tokë që të punojmë, që të punojmë me mjete. Sot i kemi atë gjitha mjetet që i ndajnë funksion dhe pothuajse çdo ditë. Njësitë kryesore pastrojnë, kurse herë në 2 ditë zonat turistike dhe të gjitha janë në nivelin e duhur. Njëkohësisht, edhe për sa i përket shërbimit ndaj zjarreve, këto kenë atë të organizime dhe, pavarësisht nga kërkesat që kemi pasur pothuajse çdo vit, jemi munduar t'i përballojmë me sukses zjarret e problemet tjera që na kanë rënë, pavarësisht zonës së shumë të vështirë, shumë e hapur,

dhe shpresojmë që këtë vit të kemi një përmirësim më të mirë si me furnizimin e mjeteve dhe të punonjësve të zjarrfikësve. Faleminderit, deputete.

**Miftar Dauti:**

Për shërbimet. Sigurisht që ne jemi të ngarkuar që të kryejmë çdo lloj shërbimi që është brenda territorit të bashkisë. Mendoj që në një farë mënyre kemi bërë performancë të mirë në sektorin e mbrojtjes civile. Mendoj që në qark jemi bashki elitë për mbrojtjen e territorit nga zjarret dhe nga dëmtimet. Fatkeqësitë natyrore. Jemi bashki me bazë fshati. Që kemi shumë rrugë rurale të cilat vlejné për të dëshiruar, sepse janë të pastruara. Dhe shërbimet për pastrimin e qytetit dhe disa fshatrave që kemi arritur, kemi shtuar rrugë. Ju kemi ofruar edhe shërbimin e pastrimit, shërbimin e ndriçimit, shërbimin e gjelbërimit. Dhe po e ecim me ato mundësi tona që të performojmë sa më mirë që shërbimet ndaj qytetarëve të jenë në kohën reale, ashtu siç e meritojnë banorët. Faleminderit.

**Luçiano Boçi:**

Zoti Mazniku ta ushtrojë edhe unë kompetencën time, se po flasim për kompetencat e kryetarëve të bashkive. Kemi edhe ne komision. Atëherë t'ia kaloj fjalën zotit Dule.

**Vangjel Dule:**

Unë, zotëri 1 bashkëkryetar, duke kërkuar ndjesë që nuk isha në pjesën e 1-rë të kësaj seance, kisha 2 pyetje shumë të thjeshta për të nderuarit kryetarë të bashkive. Nëse mund të na informonin thjesht me 2 shifra, cila ka qenë popullsia e bashkive që drejtojnë në regjistrimin e popullsisë 2011 dhe regjistrimi i popullsisë 2023 në secilën prej tyre? Dhe pyetja e 2-të: sa prej nënkryetarëve kanë ndryshuar që nga momenti i dhënies së urdhrit nga kryeministri në takimin që patën me ta, ku u kërkua 1 gjë e tillë? Faleminderit.

**Albert Halilaj:**

Përshëndetje. Faleminderit për pyetjet. Në lidhje me pyetjen e 1-rë, për bashkinë e Kukësit ka qenë si bashki 36.000 banorë. Realisht, bashkia e Kukësit përfshin 61.000 banorë, domethënë shtuar edhe njësitë administrative, 14 njësitë administrative. Në lidhje me pyetjen e 2-të, më fal, nuk të kuptova se s'dëgjova asgjë.

**Vangjel Dule:**

Më falni, në lidhje me pyetjen e 1-rë, nuk them sa banorë kishte bashkia e vogël e Kukësit dhe sa ka bashkia e madhe, por bashkia aktuale, me gjithë entitetet përbërëse, ish-bashki dhe komuna në tërësi, sa ka pasur në vitin 2011 dhe sa në vitin 2023 në tërësi, bashkia aktuale.

**Speaker 7:**

Bashkia aktuale tani ka 61.000 banorë. Kukësi. 2011-ën. E kam dhënë atë të sakta, por.

**Vangjel Dule:**

Zoti Mazniku, të çojmë te ikim. Juve ju shqetëson se çfarë kërkoj unë? Domethënë, nuk ka, nuk ka lidhje me Kukësin, nuk përfshihet në atë. Çfarë ka për të mos u kuptuar? Bashkia e Kukësit, me të gjitha njësitë përbërëse të sotme, sa e kanë pasur popullsinë në vitin 2011 dhe sa e ka në vitin 2023? Kaq e vështirë që nga.

**Rexhë Byberi:**

Të nderuar deputetë, mua më gëzon fakti që. Po, po.

Fal deputet Xhelali. E kena bërë 400 km e marrë dhe. Doja vetëm 1 diçka, po.

**Arbjan Mazniku:**

Të lutem. Zoti Dule, me shumë respekt dhe pa dashur ndërhyrë në gjë, çështja është entiteti në fjalë. Në 2011-n nuk ka ekzistuar. Mënyra si kanë mbledhur censusin të dhënat në 2011-n ka qenë i bazuar në ndarjen e 2011-ës, jo ndarjen e 2015-ës. Kështu që po kërkohet të bëhet 1 ushtrim matematik në riversë në kohë, të cilin nuk e bën dot kryetari i bashkisë, ta llogarisi. Këtë të dhënë ja kërkojmë qy nesër instatit, na e llogarisi njësinë në njësi dhe na e sjell ta kemi për gjithë Shqipërinë. Po, kjo është 1 kërkesë të cilën kryetari, jo kryetari i fjalës, por çdo kryetar bashkie nuk e bën dot se nuk ka ekzistuar bashkia, territori në fjalë në 2011-n kur është bërë censusi, s'ekzistonte si i tillë. Ekzistonte i copëzuar dhe të dhënat nuk mblihdeshin në këtë format.

**Vangjel Dule:**

Pra, juve e konsideroni pyetjen të vështirë?

**Arbjan Mazniku:**

Jo, jo, e konsideroj pyetjen që personi që po i drejtohet e ka të pamundur ta ketë këtë informacion për 2011-ën. Ju e keni këtë informacion për sot, ndërkohë që informacionin pas 1 përpunimi teknik mund të na e sjellë instati për të 61 bashkitë sot dhe ta kemi, ta disponojmë për çdo çështje, se e ka detyrë instati ta bëjë këtë punë.

**Vangjel Dule:**

Zoti Mazniku, unë ju falenderoj për interpretimin. Do t'ju drejtoja juve 1 pyetje. Në qoftë se ju drejtoni 1 entitet të çfarëdo lloji, nuk do të kishin jo vetëm detyrimin për shkak të detyrës, është në job description, por edhe kureshtjen të dinin se si ka qenë ecuria demografike e njësisë të cilën drejtoni?

**Arbjan Mazniku:**

Meqë se ma bëre 1 pyetje, unë do të kisha shumë interes ta dija edhe në 2011-ën, edhe në 2020-ën, edhe në 2037-ën dhe në 2048-ën për çështje kurioziteti. Detyrën kam ta di nga momenti që e marr detyrën, të di sa ka marrë inventar atë ditë dhe si menaxhoj nga ajo ditë. Po, unë për kuriozitet mund të di edhe ore çfarë janë në 2047-ën, çfarë ka ndodhur në 2064-ën, çfarë ka ndodhur në 2038-ën.

**Vangjel Dule:**

Atëherë ta lëmë 2014-ën që.

**Arbjan Mazniku:**

Po, rëndësi ka, por ama për sa i përket detyrave të komisionit, prapë e them me shumë respekt, pyetja juaj është e drejtë dhe shumë e dobishme. Ta vendosim te lista e kërkesave për instatin dhe ta marrim për gjithë Shqipërinë dhe të themi si ka qenë struktura e popullsisë në censusin e 2011-ës dhe instati duhet të bëjë 1 ushtrim ta llogarisi, sepse nuk e ka të llogaritur në bazë të 1 ndarje administrative që nuk ekziston në 2011-ën.

**Vangjel Dule:**

Është e vështirë.

**Arbjan Mazniku:**

Jo, s'është e vështirë. Do 1 ditë punë nga 1 specialist i instatit, e bën dhe na e sjell. Kaq e thjeshtë, nuk është e vështirë, po.

**Luçiano Boçi:**

Po mirë, të bëj 1 modifikim pyetje atëherë, se po bëjmë atë ndërmjetësim. Shumë e thjeshtë, ajo që kërkon z. Dule është shumë e thjeshtë. Ka sens, sepse do që të nxjerrim pa rënien e numrit për shkak të shpopullimit. Atëherë, sa ishte numri në momentin që morët drejtimin e bashkisë pas këtë vështirë t'i drejtonit 2011-së dhe sa e keni tani? Nuk ka nevojë për census, sepse ju keni dhënat e emigracionit për secilën zonë dhe të shohim sa është shpopullimi, sepse sensi i pyetjes ky ishte, pavarësisht se në 1 dijeni këtu është subjektive që ca thonë duhet, ca nuk duhet. Kryetari i bashkisë është i interesuar ta dijë sa ka qenë popullsia, jo në 2032-shin, duke përdorur cinizëm, por në pikën më të afërt të marrjes së detyrës së tij, sepse është krahasim, është orientim, është për modalitet pune. Nuk ka rëndësi fare, mos i hyjmë gjërave. Po, o z. Elezi, se tani është bërë modë kjo, dikush flet edhe dikush ndërhyt. Tani, unë e di shumë mirë këto interpretime për mos dhënë përgjigje pyetjeve që parashtrihen, janë, ekzistojnë, se gjuhë është kjo. Mos i shmangni përgjigjet.

**Rexhë Byberi:**

Jo, atëherë për kisha dëshirë të më bëjë edhe 1 pyetje tjetër mua. Sa ndërtime po bëhen në Tropojë që ka? Po, prapë po. Kështu që. Bëjmë animovon. Tani.

**Luçiano Boçi:**

E ke re, Xheke, sa ndërtime mbi 6 kate bëhen, sa të drejtë ke ti t'i japësh? E po, e po, na pra ja e dhe përgjigjen kështu që, kështu që mos hy ke kjo sfidë kot, domethënë se e ke të humbur, dakord? Po jo, e doje pyetjen, ta bëra pyetjen, prapë.

**Arbjan Mazniku:**

Pjesë ndihmës për çështje kështu. Z. Duli, kishte 1 pyetje të dytë për të gjithë projektin?

**Vangjel Dule:**

Nuk mora përgjigje për pyetjen e 1-rë, por meqë ka njerëz që janë më të interesuar se kryetarët e bashkive për ecurinë demografike të bashkive të tyre, më thonë se Bashkia e Tropojës, në formën që është sot, pasi bëri 1 mbledhje të vogël elementare, në bazë të

regjistrimit të 2011-s, ka qenë 20,517 banorë. Në censusin e vitit 2023 ka qenë 14,189 banorë. Ndryshimi është -6,328 banorë. Rënia është -31%. Është larguar rreth 1/3 e popullsisë gjatë kohës që është në fuqi reforma territoriale administrative. Nuk e di nëse keni të dhënat e vitit 2005, zoti kryetar, nëse është shtuar apo është pakësuar edhe më tej popullsia. Po, si ka mundësi që ju e shikoni ndarjen territoriale funksionale? I keni shtrirë shërbimet edhe më cilësore në të gjithë hapësirën dhe unë nuk kam asnjë arsye që t'ju kundërshtoj ose ta vë në dyshim ndërsa njerëzit largohen.

**Luçiano Boçi:**

Atëherë, përgjigjja juaj? Nderuar kryetar.

Po e bëri pyetjen zoti Dule, po po.

**Rexhë Byberi:**

Për shërbimet nuk largohet kush. Përkundrazi, kanë nisur edhe po vijjnë, e po kthehen, e po ndërtojnë me qindra banesa, me qindra biznese. Vijnë edhe nga jashtë Shqipërisë, po kthehen edhe mua më vjen mirë që po kthehen. Prandaj tash që më vjen mirë që kanë nisur të gjitha ato ndërtime në qytetin e Bramcurit që nuk ka 25 vjet që nuk është bërë 1 ndërtim. Tash lëvizja është e lirë.

**Luçiano Boçi:**

Po, zoti Alilaj, po. Zoti Dauti, kush e merr fjalën?

**Miftar Dauti:**

Atëherë, faleminderit. Bashkia HAS është 1 bashki me gjendje civile 23,000 banorë. Dhe në dyzetet e fundit, në 2003-in dhe në 2005-n, kanë marrë pjesë në votime 8,108,000 votues. Sipas censusit të fundit, Bashkia Has ka dalë me 1,000 banorë. Që kur bëhet fjalë me numrin e votuesve, nuk përputhet, besoj, me censusin që është bërë, sepse të marrin pjesë 8,000 vetë në votime dhe dalin popullsia 1,000 vetë, nuk përputhet, besoj. Sepse në 2005-ën nga Londra kanë votuar diku afërsisht 900 vetë. Domethënë 7,100 prapë kanë qenë banorë. Banorë në Has.

**Luçiano Boçi:**

Kjo shifër ha debat, zoti Dauti, se mund të jenë banorë që jetojnë në shtetet kufitare, kanë ardhur dhe kanë votuar dhe nuk janë prezent ose s'kanë qenë në momentin që është bërë regjistrimi i censusit. Mirë, zoti Alilaj.

**Albert Halilaj:**

Të dhashë përgjigjen, por.

**Luçiano Boçi:**

Po ishte pyetja tjetër, në qoftë se e dgjove.

**Albert Halilaj:**

Lidhur me lëvizjen demografike. Siç dihet, pjesa më e madhe e kuksanëve janë aktualisht në Kukës. 1 pjesë e vogël ka lëvizjet përkohshme në Tiranë, Durrës dhe nuk është 1

përqindje shumë e madhe. Mund të jetë 6 përqind e popullsisë së Kuksit që ka lëvizjet përkohshme, por Kuksi është i tejmbushur me banorë dhe është 1 qytet në zhvillim dhe s'mund të jetë kundra gjithë ato hipoteza që Kuksi është i boshatisur.

### **Luçiano Boçi:**

Sipas dhënave që vijnë, qarqet më të boshatisura janë qarqet e veriut, kryesisht, përjashtuar Elbasanin, dhe s'mund të dalim në këtë lloj teze, sepse nuk janë dhëna që vijnë nga Partia Demokratike, po vijnë nga instati, nga institucionet shtetërore, dhe ne këtu duam që të transmetohet e vërteta bruto që vjen nga territoret tuaja, sepse statistikak ne i kemi dhe statistikak qëndrojnë, vetëm po i hodhët ju poshtë statistikak. Dhe mos harrojmë edhe 1 gjë tjetër, sepse mund të flasim, po statistikak tregojnë prapë që qarku i Kukës është ndër qarqet më të varfra të Shqipërisë, se këtu u fol për zhvillimin ekonomik, për gjërat fantastike, më i varfri, po më i varfri. Kështu që këtë gjë mos e shmangim, sepse thamë ke vëmendja, na dëgjojnë qytetarët sot, dhe ai qytetari që është shumë larg dhe nuk merr shërbimin, normal që reagon, sepse u bë dhe 1 pyetje nga krahu i maxhorancës, cilat janë ato shërbime që nuk ofrohen ose ka zona të cilat nuk marrin shërbime? Këtu s'u dha asnjë përgjigje. Në qoftë se ju jeni me standard të përcaktuar shërbimesh, të shpërndarë në gjithë territorin, na e thoni dhe cili është ky standard, por duhet të na e kishit thënë. Nuk po kërkoj përgjigje, po bëj 1 koment se pyetjet e mia pastaj mund t'i bëj në fund fare. Atëherë ka kërkesë, po zoti Elezi nga maxhoranca.

### **Ermal Elezi:**

Po, dhe unë do isha që të mbaj mirë pyetjet, se te komentet pastaj, edhe kur ai i Bashkisë Hasit që e keni të frontit tuaj nuk ju pëlqen përgjigja, përpiqeni t'ia riformuloni përgjigjen dhe has debat. Tani, në lidhje. Janë kryetarë bashkie të zgjedhur nga subjekt të caktuar. Unë e kuptoj që mund t'ju shqetësojë e vërteta, po e vërteta kjo është. Ajo që unë shoh shqetësuese në lidhje me qarkun ka të bëjë me të ardhurat e veta që kanë bashkitë. Të treja bashkitë, ç'është e vërteta, edhe pse me diferencë nga Kuksi që i ka çik më të larta, pastaj Tropoja, pastaj Hasi, janë gjithsesi mjaft ulëta dhe peshën kryesore e marrin në buxhet nga transfertat qeveritare. Doja të kuptoja si funksionon në bashkitë tuaja mbledhja e të ardhurave dhe si e vlerësoni këtë lloj performance. Gjithashtu, çfarë mendoni që nuk funksionon nga ana juaj? Çfarë mendoni që nuk funksionon nga ana e taksave, qoftë dhe për atë që u përmend decentralizimi fiskal? Dhe a keni sugjerime për 1 mbledhje më të mirë të tarifave vendore? Dhe po e lidhur me diversifikimin e të ardhurave, duke qenë se jeni 1 set bashkish, qarku ku ka mundësi bashkëpunimi me ato që janë programe tipa ndërkombëtare, keni përvoja të ngjashme? Dhe çfarë sfide paraqesin për ju? Faleminderit.

### **Luçiano Boçi:**

Po, fjala për ju, zotëri kryetar.

### **Albert Halilaj:**

Lidhur me menaxhimin e taksave nga ana e bashkisë, është 1 trend në rritje vit pas viti në lidhje me menaxhimin, arktimin e të ardhurave vendore. Ka nevojë edhe për përmirësime, kryesisht për taksën e familjarëve, të cilët jemi në 1 marrëveshje. Po e mbyllim së shpejti me ujësjellës kanalizimeve për të qenë ai agent i vjeljes së kësaj takse në lidhje me bashkëpunimin me zonat kufitare, kryesisht me bashkinë, komunën e Prizrenit. Bashkia Kukës ka 2 projekte ndërkufitare, e cila ka aplikuar edhe thirrjet e hapura që kanë qenë dhe kemi pasur edhe 1 bashkëpunim në lidhje me infrastrukturën rrugore në zonën e

njësisë administrative Zapot, e cila ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës, kanalit të urave të zeza të asaj zone në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës. Kemi po. Edhe jemi në kontakt si me bashkinë e Gjakovës, komunën e Gjakovës edhe komunën e Prizrenit për të pasur bashkëpunime të tjera ndërkufitare kryesisht në infrastrukturë.

**Rexhë Byberi:**

jepen nga këto 3 hidrocentrale që janë në territorin tuaj, ju merrni 0 lekë. Dhe unë besoj që ju, si dhe të gjithë vendet e rajonit dhe të BE-së, do të donit që të merrnit taksë nga shfrytëzimi i kësaj sipërfaqe bujqësore, turistike apo tregtare, ka qenë më përpara, por që sot nuk është. Së dyti, edhe për minierat. Pra, duhet të realizuar siç kanë kolegët tuaj, nëse dilni në Kosovë apo kudo në çdo vend tjetër të rajonit dhe të BE. Së dyti, ëëë, qarqet, çaku juaj, si dhe e gjithë Shqipëria, nuk e ka përmbushur atë kauzën e 2015-s, sepse shohim një rritje progresive, ndonjëherë, të fondit të pagave. Dhe mjafton po të shohësh se si ka shkuar tendenca të 3 bashkive që ju drejtoni dhe në Tropojë është rritur 3 herë, në Kukësë është rritur 3 herë, në Has është rritur 4 herë. Po me një dallim, se Hasi, të paktën në këtë mandatin e fundit, vetëm kishte shkurtuar nga vendet e punës, sepse në ato 2 mandatet e para ishte rritur 4 herë. Dhe nuk e kuptoj kur ka ekonomi shkalle. Pra, kur mblidhet siç është Kukësi, se Kukësi pas Dibrës është bashkia që ka më shumë njësi vendore të përfituara. Dibra kishte 15, Kukësi ka 14. Dhe më thuaj mua se si, se si mundet, po themi, që mblidhen 15 bashki dhe që kanë, po themi, një strukturë të harmonizuar dhe trefishohet administrata. Pse trefishohet? Kur ka përqendrim në një vend, nuk ke më, po marr rastin 15 apo 14 drejtues financë, po ke vetëm një. Nuk ke më 15 drejtues urbanistike, po ke vetëm një. Pra, çfarë do të thotë që duhet të ulet, por është dyfishuar apo trefishuar administrata, natyrisht është rritur edhe niveli i pagës, që unë nuk jam kundër nivelit të pagës, por jam kundër rritjes së administratës, e cila nuk kthehet në rentabilitet për qytetarët, për t'ju shërbyer, por shërben si një shtojcë elektorale. Dhe jam absolutisht i bindur që më shumë se sa 50% e administratës që ju drejtoni, nuk janë efektive, nuk e kanë një vend pune dhe ndërkohë, jo më kot, po të shohësh, ka shkuar, po themi, fondi i pagave dhe sigurimi shoqëror, në vend që të ulej, ka shkuar gati në 15-16% më shumë se sa kur kishim 373 njësi vendore. Një tjetër element po marr Kukësin. Nuk e kuptoj se si mund ta menaxhojë kryetari i bashkisë Kukësin, që fillon që nga Shishtavetë si në kufi me ekstremin e Prizrenit, me Kalisin e Kukësit, që është në kufi me Dibrën, me Arnin, që është në kufi me Mirditën dhe me Lurën, që një banor nga këto 3 zona, minimalisht, i duhet për të ecur nja 4 orë, 5 orë me makinë. Dhe jam absolutisht i bindur që të 3 këto zona, 0 investim është bërë. Kujtoj, të 3 këto komuna, kur kanë qenë komuna deri në vitin 2015, ka patur investime, sepse shkonin në mënyrë drejtpërdrejtë atje. Tashmë, jo për shkak të oreksit të kryetarit të bashkisë, sepse çdo kryetar do të tentojë për të investuar në qendrën e qytetit, pastaj atje ku ka më shumë banorë, e kjo ka sjellë për pasojë, po themi, largimin masiv nga këto njësi vendore. Po të shkoni në Kukës, nuk sheh më banorë që ka pasur me qindra dhe me mijëra banorë. E njëjta gjë ndodh në Arnin e Kukësit, apo dhe në Shishtavetë, apo dhe kudo. Pra, ka një disproporcion të jashtëzakonshëm, por që ka ndikuar në mënyrë drejtpërdrejtë, po themi, për shpopullimin e këtyre zonave. Natyrisht, kur ka shpopullim, nuk ka bujqësi, nuk ka blegtori, nuk ka më arsim, nuk ka më shëndetësi. Një tjetër element, ju e keni parë edhe në Kosovë, ka kompetenca tjera. Bie fjala, arsimi parauniversitar menaxhohet nga bashkitë. Në Shqipëri nuk është. Pse nuk e thoni? Sepse i keni komshinj, po themi, Gjakovën, Prizrenin. Ju e dini që qakullimi rrugor brenda qytetit e tjerë e menaxhon bashkia. Pse nuk e thoni? Ju e dini se sa grant morin nga buxheti i shtetit bashkitë, që i keni matar në kufijtë, dhe sa merrni ju? Ju merrni 1% keni pasur marrë grant fillim viti, 1% merrni sot. Ku keni parë ju, siç e thashë pak më përpara, 3 bashki më të varfra të Shqipërisë, sepse taksat ja merr buxheti i shtetit dhe nuk ka një fond balancimi, siç aplikohen në të gjithë vendet e BE. Pra, bashki të cilat nuk kanë kapacitet, buxheti i shtetit i kompenson me një fond të caktuar, që të krijojë një balancë për të mos kaluar në ekstrem me qytetet e tjera, se përkundrazi, ç'punë ka një qytetar që të rrijë në Tropojë, apo të rrijë në Has, apo të rrijë në Kukës, kur targat e tij për frymë janë 3 herë, 4 herë, 5 herë, apo ndoshta edhe 10 herë më pak se sa një banor i zonave të tjera të Shqipërisë? Nuk e di nëse do të ishte dakord Hasi që t'i bashkohej Kukësit. Nuk e di a do të ishte dakord Tropoja, apo do të ishte ju dakord që t'i

bashkoheshit Kukësit, siç është filozofia e kësaj qeverie. Apo, do të kërkonit, po themi, siç thashë raste pak më parë, që të krijohet, po themi, një bashki në Shishtavetë, sepse është si me qenë një shtet tjetër për të shkuar në Shishtave, apo për të shkuar në Bicej, apo për ta patur, po themi, në Ujëmisht, apo diku tjetër për të patur një bashki. Se po bëj po prapë një krahasim. Pothuaj sa GJirokastra jeni? Ju keni 3 njësi vendore, GJirokastra ka 7. Por jam i sigurt që në çdo lloj rankimi ekonomik etj., çaku i Kukësit është shumë herë më keq, sepse e ka distancën e jashtëzakonshme, siç e thashë rastin, të paktën të bashkisë. Kështu që, a nuk do të ishte normale që të kishte, të paktën në Kukësi, edhe 3 bashki të tjera, për ta bërë më të menaxhueshme, për të qenë përfitues? A nuk është normale të operohet siç jepeshin më përpara grantet, që jepeshin direkt bashkive dhe komunave? E dinë rejtë që se ka përfituar nga ato grantet konkurruese që jepte para 2013-s. Sot grantet vjen dhe ua merr AZHPR-ja, që është ajo, kjo e zhvillimit të rajoneve. Po, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Pra, nuk i merrni ju këto kompetenca dhe më mirë se sa e dini ju se ku ka nevojë, nuk ka në asnjë vend tjetër. Ka edhe probleme të tjera, në të cilat unë do t'i diskutoja, edhe mund t'i thoja me ju, por për të mos i konsumuar, pasi kemi patur edhe një qakbak përpara, edhe një tjetër që do vijë më vonë. Por do të kërkoja edhe njëherë qasjen tuaj. A do ishit ju dakord për këtë delegimin e këtyre kompetencave? A do ishit ju dakord që të unifikoheni në një qendër qarku? Centralizim? Besoj që rejtë që e dinë që Margegaj do kishte qenë më mirë po t'i shtënë vetes, sesa po t'i shtënë bashkë me Tropojën. Sepse, pavarësisht se ka qenë kryetar komune atje, nuk ka të njëjtën vëmendje për Margegajn, siç ka për qendrën e qytetit. Dhe kush do të ta bënte atë? Dhe unë po të isha aty, më shumë do merresha me qendrën e qytetit, sesa me periferinë.

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Mziu, me shumë respekt.

**Arbjan Mazniku:**

Me shumë respekt, zoti Mziu.

**Arbjan Mazniku:**

E di, po kemi rreth 20 minuta që flisni ju, e kemi thirrë kryetarin.

**Xhelal Mziu:**

Kur e mor fjalën unë, tashi, nëse kam bërë edhe 10 minuta, unë e mbyll. Në të kundërt, shife pak orarin.

**Arbjan Mazniku:**

Ka 20 minuta.

**Xhelal Mziu:**

Kështu që, këto do të donim opinionin tuaj, pa implikime, po themi, politike, se kush mund të jenë qasjet dhe a do të ishit dakord, po themi, që mbështetja financiare që t'u jepej bashkive, përtej këtyre targave kombëtare që unë thashë pak më përpara, të trajtoheshin si vendet, apo si qytetet e Kosovës, apo të vendeve të tjera, që të kishin mundësi financiare për të përmbushur, po themi, nevojat e qytetarëve. Faleminderit!

### **Albert Halilaj:**

Përshëndetje, deputet! Faleminderit për pyetjet që shtruat. Në lidhje me menaxhimin e territorit në bashkinë e Kukësit, ju informoj në lidhje me merakun që kishit për rritjen e fondit të pagave. Kjo bëhet kryesisht për indeksimin e pagave. Në përgjegjësinë time të deklaroj që vetëm 6 punonjës janë shtuar nga ana ime, edhe duke pasur relacionet përkatëse tek drejtoria përkatëse. Në lidhje me shërbimin e pastrimit për njësi të administrative, që nëse tani qendrat e njësive administrative janë apo s'janë në fokus nga bashkia aktuale, unë ju them me përgjegjësi se në shumë njësi administrative është ndërhyrë, kryesisht në Shishtavetë, në qendrën e Shishtavetës, është bërë edhe rruga e Kallabakut nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në njësinë administrative Topojanë, që është zonë e thellë, është ndërhyrë nga ana e bashkisë dhe është asfaltuar rruga në vlerë 1.3 milion euro. Në komunën Bicaj, ose njësinë administrative Bicaj, është ndërhyrë nga fondi...

### **Albert Halilaj:**

Thonë, edhe në lidhje me propozimin që kishit ju, nëse Kukësit i duhen, ose 3 bashkive, ose jo, unë jam mendimi që Kukësi është funksional në lidhje me këtë, me bashkinë. Sepse secila ka zonë, ka karakteristikat e veta, zakonet, traditat, edhe përbëhen... Në qendër është prefektura edhe qarku, i cili përfshin edhe institucione. Për delegimin e... Për, domethënë, në lidhje me funksionet që kryhen nga bashkia e Hasit dhe Tropojës, do japim përgjigje kryetarëve.

### **Rexhë Byberi:**

Përsa i përket Tropojës, mendoj dhe kërkuj që të jenë bashki e veçantë, siç është sot. Për sa i përket shërbimeve, i nderuar deputet Xhelali, të them sinqerisht, brenda bashkisë së Tropojës, shërbimet kryhen më mirë se unë kam qenë kryetar i një komune ku ju përmenda. Për vetë arsyen, sepse urdhëro?

Jo, po kaloj aty tashi. Po kaloj aty. E la ëmbëlsirën për në fund. Dhe mendoj, këto bashki si janë shumë të pasura, se bashkia ime nuk është bashki e varfër. Ka resurse, nuk mund t'i themi është bashki e varfër. Këto resurse t'i gëzojnë ai komunitet dhe t'i japin detyrimet e veta ku i takon pjesën. Po të kenë edhe detyrimet, ato targat e veta. Kështu që mendoj që edhe ecet, edhe ato të marrin diçka, edhe bashkia e Tropojës, bashkia e Hasit, sepse kanë pasuritë e veta. Shërbimet, e thamë se u bë e njëjta pyetje shpeshherë, kryhen më së miri. Kavanë për të përmirësuar, kavanë për të përmirësuar. Ndoshta e njihni veten më komod se jeni në opozitë tash, ja thoni tash. Por dëshirojmë të vini të shohim, ju thashë edhe njëherë. Ja, sepse ma përmend një deputetin tim, që e kam për shpirt Isufin, për 8 vjet s'ma ka shkelë njëherë zyrën e bashkisë. Siç jam unë i votuar, kryetar mos më ngacmo, se e kam më shumë të sinqertë. Lëre të shpërthejë. Kam dëshirë të komunikoj, se ne, siç është zgjedhur Isufi në Tropojë, jam edhe unë i zgjedhur. Të komunikojmë, të ishte edhe Isufi sot këtu. Tani ishim nga fletët, jo të flasim në... Zoti.

### **Luçiano Boçi:**

Kështu që, zoti Byberi, tani përqendrohuni tek përgjigjet tuaja.

Po edhe unë po përqendrohem, sepse marrëdhëniet midis jush, deputetëve, kryetarit të bashkisë, nxjerrin çështjen jashtë linjave.

### **Miftar Dauti:**

Kaq e kisha edhe unë. Atëherë unë nuk do ta zgjati shumë. Në kuadrin e propozimeve, si deputetit Isuf Çela, zonjës Tabako, zonjës Xhelali, zotit Xhelali, sigurisht që brenda territorit të bashkive të qarkut tonë, çdo pasuri që është, duhet të ndahet një pjesë për territorin e bashkive, sepse ne të zgjedhurit, kushdo qoftë i zgjedhur sot, jam unë, nesër dikush tjetër, më mirë se e dinë i zgjedhur kujt dhe bashkisë vetë, nuk mundet me e ditë dikush tjetër. Faleminderit!

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zonja Koçeva.

**Marjana Koçeku:**

Faleminderit bashkëkryetar! Mirë se erdhët, të nderuar kryetarë e bashkish. Atëherë, pyetja ime për ju është, të njëjtën pyetje ju kam bërë edhe kryetarëve që ishin para jush këtu, në fakt. Është, secila metodë ose strategji, mendoni ju që do ishte më e duhura për me ndjekë Komisioni i Reformës Territoriale, për me zbutë, sado pak, pabarazitë territoriale, që nuk mund të thona që nuk ekzistojnë, midis qendrave kryesore, pra qyteteve dhe zonave më periferike. Kjo, si në investimet publike, financat, po ashtu edhe resurset humane. Dhe një shtojcë tjetër e kësaj pyetjeje është se, a mendoni ju që një metodë ose një instrument mund të jetë fuqizimi i njësisve administrative? Këtu marr shkas edhe për shkak se territori në bashkitë tuaja, por jo vetëm, kryesisht në bashkitë e veriut të vendit, ka mjaft zona shumë të thyera malore, siç mund të jenë Curajtepërm, Nika e Mërturë, etj., ku qoftë edhe një individ i vetëm, një familje ose më shumë, pavarësisht numrit, unë besoj se meriton ta ketë shërbimin ashtu siç e kanë edhe të tjerët. Pra, të ndihet i përfaqësuar. Aq më tepër, unë besoj se këto zona që janë edhe më të thyra, përkundrazi, meritojnë edhe më shumë incentiva dhe mbështetje që të qëndrojnë edhe të zhvillohen në ato zona ku janë. Këtu, pas parasysh edhe se janë zona të frekuentuara nga ana e turizmit. Faleminderit!

**Albert Halilaj:**

Përshëndetje, deputete! Ju falenderoj për pyetjen. Është me të vërtetë një pyetje e cila ka impakt, se ka të bëjë me performancën e bashkive dhe për mendimin tim, një ndër faktorët kryesorë do ishte edhe arktimi, për shembull, përformimi në lidhje me arktimin dhe taksat vendore. Dhe në pjesën në ato bashki të cilat e kanë të pamundur të mbulojnë një plan investimesh, një plan shërbimesh për komunitetin, do subvencionohen nga ana e qeverisë dhe është një për të falenderuar një nismë e Ministrisë së Pushtetit Lokal, e cila ka të bëjë me grantin e performancës dhe mbas edhe punës së secilës bashki, të vlerësohet ndikimi i qeverisë në mbështetje me fonde për vijimin normal të punëve që ka bashkia. Faleminderit!

**Rexhë Byberi:**

Me Shkodrën. Dhe shpresoj që të kem edhe ndihmën tuaj. Sapo ka përfunduar projekti që lidh Qafën e Adhërit, miratu leja dhe është gati për t'u financuar. Sapo ka përfunduar projekti i rrugës Curajepër dhe është drejt financimit. Projektet janë dorëzuar tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit. E them këtë që mua nuk e merituan lekë bibaj, sepse janë zona më e largët nga qendra e qytetit Baramcura dhe ne po bëjmë të mundur që të lidhemi me Shkodrën. Ku do i jepet një impakt edhe lëvizjes së njerëzve me gjakun në gjakun, por edhe zhvillimit ekonomik, siç janë zonat malore dhe turizmi malor. Dhe ne po bëjmë çmos për tani kuptohet që këtu duhet të ndërhyjnë pushtetet qendrore të na mbështesin me

fondet që ne projektet i kemi gati. Po kështu, pothuajse në disa fshatra ku kanë probleme me largësinë. Pavarësisht se ne 12 fshatra me buxhetin e bashkisë së Tropojës i kemi përfunduar asfalt, e thashë më parë, po përgatitim tash edhe 2-3 të tjera. Kërkojmë që mbështetja e qeverisë duhet të jenë sidomos për bashkinë e Tropojës dhe bashkitë që janë më larg, meqenëse projektet ne i kemi hartuar, kaq kemi mundësi na si pushtet vendor.

#### **Miftar Dauti:**

Faleminderit, deputete! Sigurisht që për njësitë vendore unë jam. Që njësitë vendore të njësitë administrative të forcohen. Sepse brenda një njësie administrative është një territor dhe një komunitet i gjerë. Dhe shërbimin që mundet me e marrë një banor i një fshati afër në njësinë administrative do t'i kushtonte shumë më pak kohë sesa të vinte në tek bashkia e madhe. Kështu që unë them që në kuadër të reformës së administrative territoriale të shikohet edhe kjo çështje që njësitë administrative, të paktën për pjesën, për pjesën emergjente që shërbime emergjente që janë brenda brenda territorit të njësisë administrative të jenë kompetente ato. Faleminderit!

#### **Rexhë Byberi:**

Edhe merak kisha. Kemi rrugën e Qafë Prushit. Që lidh Gjakovën me Qafën e Pushë Zogaj është një rrugë që aty pothuajse të gjithë mineralet e kromit aty nxirret faktikisht. Ka 30 e sa vjet që ia rrugë nuk është ju ka nënshtruar. Lidhës ajo ka kryer edhe funksione ku ishte lufta. Shpresoj që edhe rruga Qafë Prushë Zogaj të marrin dhe mendjen e duhur. Projekti është i gatshëm. Ai popull pret që rrugët t'i vihet siç e meriton. Që t'i kthehen edhe njerëzit kanë filluar t'ua kthehen dhe besoj që flas për deputetë, por edhe deputetë të opozitës bashkohen bashkë. Unë qëllimi i mirë të bëjmë më të mirën për këta njerëz ku jenë. Respekt.

#### **Edmond Haxhinasto:**

Faleminderit, i nderuar kryetar. Shumë shkurt, unë shikoj që janë disa tipare, në fakt, të qarkut tuaj dhe të bashkive përkatëse. E 1-ra që të 3-ja bashkitë kanë një identitet etnokulturor shumë spikatur. E 2-ta është që është qarku më i varfër i Shqipërisë, ndërkohë që potencialet janë të jashtëzakonshme. Është gjithashtu edhe zona më malore e Shqipërisë. Që distancat nga qendrat e bashkive janë më të larta në Shqipëri. Nëse ka një mesatare europiane 30 minuta nga qendra e njësisë vendore, unë personalisht di që është 1 orë e gjysmë nga Kukësi, për shembull, Buzëmadha. Është 1 orë e gjysmë, të paktën. Distançë. Po kështu, mund të them se është qarku që ka largime masive. Flas për Hasin, gjysma e Hasit është në Kosovë dhe gjysma e pjesës që është në Shqipëri është në Londër apo në Angli. Mbretërinë e Bashkuar. Reforma 2014-15-s, në fakt, nuk ka sjellë asgjë në aspektin strukturor për përmirësimin e jetës së banorëve atje. Performanca që ka ardhur në rritje, veçanërisht për Kukësin, ka ardhur si rezultat i rritjes kumulative ekonomike, ndërkohë që autonomia fiskale ka pasur përkeqësim. Mbas zonave që na janë vënë në dispozicion. Kështu që këtu besoj që rasti është shumë i thjeshtë. Nuk mund të flitet në asnjë skenar për konvergjim ose për unifikim, për bashkim të mëtejshëm të këtyre njësisive. Përkundrazi, unë dalloj që situata juaj ka të bëjë me qeverisjen qendrore, në kuptimin e mungesës së mirëfilltë të vëmendjes për t'u mbështetur me infrastrukturë, me investime. Dhe në fund të fundit, për të marrë edhe atë që ju takon për një rend minerare apo për një përqindje të të ardhurave që krijohen nga burimet natyrore që kanë zonat tuaja, për t'u kthyer te komuniteti dhe për t'u shërbyer atij. Kështu që unë vetëm një pyetje kam. Edhe këtë përgjigjen e kërkoj telegrafike. Nëse ju shikoni që potencialet tuaja

ekonomike mund të vijnë nga ndonjë bashkëpunim mes jush, ndonjë formë bashkëpunimi mes jush? Apo ju i keni kapacitetet që ta bëni këtë vetë? Kjo është pyetja. Faleminderit!

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, zotja Gjinasa. Kryetarët, sipas rendit që duan.

**Albert Halilaj:**

Faleminderit deputetit për pyetjen që kishte. Në lidhje me këtë, ne kemi një bashkëpunim të ndërsjellë shumë të mirë ndërmjet bashkive. Konkludojmë në takimet përbashkëta, në thirrjet e hapura të BE-së, në konsulta, por në lidhje me sipërmarrjen, këto besoj duhet të kenë njëfarë garancie edhe nga qeveria për të mbështetur që të funksionojë një sipërmarrje ndërmjet e përbashkët ndërmjet bashkisë së Kukës, Hasit dhe Tropojës. Jam në atë mendimin që shumë operatorë që ushtrojnë aktivitete në Kukës, Hasit dhe Tropojë, kryesisht në Kukës, kryesisht hecët dhe mineralet, një pjesë të konsiderueshme, sipas akmarrëveshjes që mund të bëhet ndërmjet pushtetit lokal, kryesisht bashkive, respektive dhe Ministrisë së Ekonomisë, që një pjesë e rendit të kthehet mbrapsht në formë granti në fund të vitit, sipas raportimeve në bashkitë e Kukës, Hasit dhe Tropojës. Këtë nismë e mbështes dhe me të vërtetë Kukësi, në statistikat, është qytet i varfër për shkak të pozicionit gjeografik dhe klimës, por ne jemi munduar që të jemi më pranë qytetarëve. Ka nevojë për përmirësime. Jemi të hapur për diskutime, për mbështetje dhe ju falenderoj për interesin që shfaqet.

**Arbjan Mazniku:**

Bashkohen, kryetarët.

**Miftar Dauti:**

Atëherë, deputet, sigurisht që nismat janë të mira. Sigurisht ajo zonë, po flas për bashkinë e Hasit, është një zonë me potenciale. Që nëse do ketë politika të mira qeveritare, mund ta shfrytëzojmë për mirë. Si për të ardhurat e bashkisë së Hasit, si për të ardhurat e shtetit në përgjithësi. Sepse është zonë kodrinore malore, e zhveshur, që mund të përdoret. Dhe mund të shfrytëzohet mjaft mirë për resurse energjetike. Erë, dielli. Që më thanë në përgjithësi vetëm nga Hasi, nëse shfrytëzohen të gjitha resurset që ka Hasi, mund të prodhojnë sa 2 herë firza energji elektrike dhe Hasi mund të kthehet në një bashki. Bashki energjetike, bashki me potencial të madh energjetik, duke qenë edhe si bashki ndërkufitare me Kosovën. Duhet që vetëm qeveria shqiptare ndërmarrin politikat e duhura për shfrytëzimin e këtyre resurseve. Faleminderit!

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Likaj, të lutem, është i fundit që ta mbyllim dhe të fillojmë me Durrësin, se kemi jemi njohur me vonesë 20 minuta që na presin.

**Ramadan Likaj:**

E 1-ra, mu mishëruat shumë mendime dhe shumë pyetje sot. Kur unë pava te 3 kryetarët e bashkive të qarkut të Kukësit, që pjesa më e madhe e të gjithë aktivitetit të tyre deri sot ishte pothuajse pozitiv. Dhe në këtë këndvështrim, këta e thanë vetë që nuk ka nevojë edhe për ndryshime territoriale, që janë shumë e rëndësishme. Pyetja ime konsiston këtu, po në qoftë se qeveria në projektin e saj do bëjë ndryshim territorial, ju a do ta pranoni?

Pyetja e 1-rë. Lidhur me kompetencat. Mendoj që kompetencat pushtetit lokal i ka të cinguar. Reç, besoj që e dinë shumë mirë. Sigurisht që unë e përgëzoj për gjithë performancën që ti bane. Dhe pyetja e 2-të është: Kush janë ato kompetenca që realisht pushteti qendror sot ia ka marrë pushtetit lokal, që duhet t'i rikthehen pushtetit lokal për interesa të rritjes së të ardhurave të tyre për t'i shërbyer komunitetit? Pra, këto janë ato pyetjet tona të rëndësishme që duhet të vijnë nga ju, që nesër ne të kemi mundësinë si komision t'i përfshijmë në një raport edhe deri ku mund të arrijmë. Se ne i dimë pak a shumë kush janë, kush janë ato kompetenca që realisht pushteti qendror ia ka marrë pushtetit lokal. Se në qoftë se ne po citojmë disa gjëra, sot kadastra është një institucion shumë i rëndësishëm për pushtetin lokal. Në qoftë se ne sot marrim lejen e ndërtimit, pushteti lokal ka vënë një tavan atje dhe thotë: "X deri këtu." Ti çdo lloj kërkese, çdo lloj kërkese, çdo lloj problematike që ti ke, ti duhet të marrësh lejen nga pushteti qendror, kur në një kohë, siç e thatë edhe vetë ju, të gjitha këto problematika vijnë edhe përplasen te pushteti lokal. Ujësjellës është shumë i rëndësishëm. Këto janë probleme të përditshme. Që realisht pushteti lokal nuk i zotëron. A mendoni ju se të gjitha këto problematika duhet t'i rikthehen pushtetit lokal për me pasë një ecuri efikase në shërbim të qytetarëve? Dhe po flas për bashkinë e Kukësit edhe të Hasit, se Tropoja si masë të saj na ke kanë rregull. Unë duhet të përgëzoj maksimalisht, po ja them sinqerisht, 2 deputetë të qarkut të Kukësit, siç është Isuf Çela dhe Flamur Hoxha, që jo se unë e them si opozitar, por unë e them për punën e tyre. Në atë parlament, gjithë kohën ata flasin për hallet e problemet e qarkut të tyre. Absolutisht. Jo, s'du t'i ngeli në adresë, ajo e dinë shumë mirë. Ajo është më e vetëdijshme se kur kush, a kupton? Tjetër se për momentin ndodhet atje, po shpirtërisht prapë te ne është, as se vjen ky dyshim kyt. Ndaj e them që, ndaj e them që pak a shumë këto ishin pyetjet e mia. Pyetje të thjeshta, konkrete, qarta. Faleminderit!

#### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit! Do i kërkoja kryetarëve të bëjmë komentet shkurtimisht të pyetjeve të zotit Likaj, gjithashtu dhe komente përfundimtare ose diçka që kanë për të shtuar, duke qenë se duhet të fillojmë me Durrësin, me të cilin jemi 1 orë e gjysmë me vonesë, kështu që... Ok, faleminderit! Zoti Ali Lej.

#### **Albert Halilaj:**

Faleminderit deputetit për pyetjet dhe sugjerimet dhe opinionin që shprehu për punën tonë të bashkive të Kukës, Hasit dhe Tropojës. Duhet të them se në lidhje me këtë diskutim i gjerë publik që bëhet në shkallë vendi, ne jemi për të përmirësuar ato gjëra që nuk funksionojnë si duhet dhe ato që performojnë, t'i mbështesim me fonde që të performojnë akoma më mirë në vite. Në lidhje me kompetencat e pushtetit lokal, besoj ne jemi në fazën e 1-rë të implementimit të kompetencave dhe janë shumë gjëra që duhen vlerësuar, që tash edhe në fund të vitit ne kemi formularin e performancës të çdo bashkie që e depoziton pranë Ministrisë Përkatëse, ku janë të përfshira shërbimet, nivelin e performimit, arktimet, rritjen e borxhit, uljen e tij e me radhë e me radhë për një sërë komponentësh. Në lidhje me shërbimin e kadastrës, ne kemi një zyrë të veçantë dhe kam të caktuar 2 inxhinierë në lidhje me zhvillimin dhe përsheptimin e procedurave për t'u ardhur në ndihmë banorëve të bashkisë së Kukësit, në lidhje me aplikimet që kanë tek zyrat e ASHK-së. Në lidhje me administrimin e pyjeve, besoj një pjesë e konsiderueshme e pyjeve komunalë ose të bashkiakë që janë në Kukës, në pronësi të bashkisë së Kukësit, janë zona të mbrojtura. Aty ka nevojë për diskutime, por besoj ato që i bëjnë janë grupet më të specializuara që mund të kenë në objekt diskutimi për të ardhmen. Ju faleminderit për pyetjen!

#### **Rexhë Byberi:**

Deputet, faleminderit për pyetjet. Do marr kadastrën radhë të 1-rë. Ne sapo kemi vazhduar 22 fshatrat e 1-rë, po shkojmë drejt përfundimit. Pjesa më e madhe janë e njësisë administrative "Ligë Bibaj". Po evidentohen pronat që nga e 1-ra. Shpresojmë që pas marrjes së 22 fshatrave të 1-rë që bëhen, do vazhdojnë edhe 22 të tjera dhe po shkojmë drejt përfundimit të ndarjes së pronave, tokës, matjen reale. Kështu është e vërteta. Për sa i përket kompetencave, dihet që kompetenca është edhe përgjegjësi. Sa më shumë kompetencë, është më e madhe përgjegjësia. Shpresojmë aty ku është e nevojshme, edhe ju si komision ta shihni, na ndihmoni dhe të na jepni përgjegjësi, jo privilegje. Shpresojmë që ne në detyrën që jemi të punojmë sa më mirë e sa më ndershëm në emër të komunitetit tonë, t'i shërbejmë me përgjegjësi të plotë, pa harruar asnjë, kudo qoftë, ku do jetojnë ata. Ju faleminderit dhe për mua ishte kënaqësi komunikimi dhe prezenca me ju sot.

**Mifter Dauti:**

Deputet, faleminderit. Ju batni pyetje që nëse qeveria do ndërmarrë një nismë. Ndryshe, për mua dhe qytetarët e bashkisë së Hasit, përgjigjen e kanë dhënë 2 dëgjesa të fuqishme publike. Që unanimisht, pa bindje partiake, domethënë janë unanimisht që Hasi tregojë identitetin e vet. E 2-ta, sa për kompetencat e shërbimit, për mua, çdo shërbim që është jetik për qytetarët, për banorët brenda territorit të bashkisë, kompetencat duhet t'i kalojnë ato institucione, duhet t'i kalojnë bashkisë dhe të mbajnë përgjegjësi bashkia për çdo shërbim ndaj komunitetit. Faleminderit!

**Arbjan Mazniku:**

Atëherë, shumë faleminderit! Po, a po zoti Ali Lej, apo ju prishi i 1-ri Kukësin? Mbaroi, prapë ka mbaruar. Kishe diçka?

**Jorida Tabaku:**

Mbasi të përfundojmë me Kukësin, kisha edhe një koment për procedurën.

**Arbjan Mazniku:**

Ok, kam vetëm një koment, meqë s'kam folur fare, do marr vetëm një minutë kohë me orën në dorë për të thënë unë dy komente në raport me dëgjesën edhe në raport me disa nga gjërat që janë thënë, që besoj që ndihmojnë diskursin publik, por edhe 2-3 argumente që nga pikëpërshtimi i numrave fryhen dhe keq informojnë dhe publikun. Së 1-ri, për sa i përket të ardhurave. Kukësi mbledh në vitin e fundit funksional buxhetor 2025, faktikun, 3,920 lekë për banor, bashkinë. Ndërkohë që merr nga granti i qeverisë 11,341 lekë për banor, 21% më shumë sesa mesatarja kombëtare, sesa merr mesatarja. Dëgjo, ju lutem, unë po jap numra. Pastaj, nga vijnë, është diskutim që e bëjmë të gjithë, po jap numra. O, o, o, zotin Albati, të lutem, të lutem, zotin Albati, të lutem, të lutem, jo, jo, jo fare, o zotin Albati, të lutem, të lutem, kam dëgjuar me respektin maksimal secilin prej jush. Kam unë të drejtën time, po atëherë respekti kërkon që mos flisni gjatë kohës së fjalës sonë, kaq. Të mbarojmë fjalimin tim, do them atë që mendoj unë. Ju kam dëgjuar, ju kam dëgjuar për 5 orë rresht fjalime nga 10 minuta, nga 12 minuta, pa ndërprerë askënd. Minimumi etik, minimumi etik, minimumi etik është të mos flisni kur flas unë, kaq. Atëherë, t'i flas qytetarëve, sepse kjo historia e zhurmës nuk ka asnjë sens. Po thosha, Kukësi mbledh 3,920 lekë për banor, merr nga granti i qeverisë 11,341 lekë për banor ose 21% më shumë sesa mesatarja kombëtare. Hasi mbledh nga taksat e veta 1,638 lekë, rreth 1/3 të asaj që mbledh Kukësi, merr nga granti i qeverisë 13,555 lekë, pra rreth 30% më shumë se Kukësi

dhe 44% më shumë sesa është mesatarja kombëtare. Tropoja mbledh nga të ardhurat e veta 3,485 lekë dhe merr nga granti 12,513 lekë ose 33% më shumë sesa është mesatarja kombëtare. Të 3 këto të dhëna tregojnë që formula e sotshme e ekualizimit tenton të ndihmojë në mënyrë sistematike dhe është e vërtetueshme me numra, që përfrymë ato bashki të cilat mbledhin më pak të ardhura se kanë më pak fuqi ekonomike, marrin faktikisht më shumë sesa mesatarja kombëtare. Ky është fakti. Thjesht po them faktet, s'po merrem me komentet. Së 2-ti, për sa i përket lëvizjes së popullsisë, nga viti 1989, që është censusi i '89-ës, në censusin e 2001-shit, në qarkun e Kukësit, siç është territori sot, kanë lëvizur, janë larguar 15,635 banorë. Nga 2001-shi, në 2011-ën, janë larguar 15,801 banorë dhe nga 2011-ta, në 2023-shin, janë larguar 11,860 banorë. Që do të thotë, lëvizja e njerëzve nga periferia, në rastin konkret, një qark malor në veri të Shqipërisë, drejt qendrave, është një element periodik, sistematik, në të 3 dekadat e fundit. Ka ndodhur me numra, rregullisht, në çdo dekadë. Ky është dhe këto që po them janë të dyja numra dhe fakte, pa hyrë në komente, dhe mendova që ishte e udhës që t'i ndaj me publikun për thjesht si informacion. Pastaj, secili njeri bën vlerësimin, komentin dhe analizën e tij. Faleminderit!

### **Luçiano Boçi:**

Po, atëherë, një ndërhyrje për shifrat. Jo, një ndërhyrje për shifrat. Xhelal, Xhelal, të lutem, një ndërhyrje edhe për saktësimin e shifrave. Gjëja e parë që kërkova në hapje të dëgjësave me kryetarët e bashkive ishte korrektesia e institucioneve shtetërore në bazë të kërkesës që drejtojnë ekspertët për dhënat e tyre, përfshirë edhe dhënat e lëvizjeve demografike. Por kjo gjë nuk ka ndodhur dhe shifrat nuk mund të përdoren si avantazh nga ana e qeverisë në raport me opozitën, e cila shifrat deri tani i ka deri në 2022-shin, sepse deri në këtë vit janë të publikuara online, duke dëshmuar edhe mungesën e transparencës. Dhe tjetra, krahasimet gjithmonë çalojnë. Edhe një krahasim, siç e bëtë ju, zoti Mazniku, çalon akoma më shumë, sepse lëvizja në 2001-shin nuk mund të krahasohet me lëvizjen në 2023-shin apo 2021-shin që ju referuat, se nuk janë e njëjta cilësi. Po, në 2021-shin, pjesa më e madhe e lëvizjes ka qenë migratore. Nga Kukësi drejt Tiranës, nga Kukësi drejt Durrësit apo qyteteve tjera të mëdha, sepse ky është edhe trendi i lëvizjes kryesor në këto vite. Ndërsa në 2021-shin dhe më përpara, lëvizja ka qenë emigratore jashtë Shqipërisë, kryesisht në 80% të saj, gjë që tregon që ka një arsye bazike dhe midis arsyeve të shumta, arsyeja kryesore është mungesa e shërbimeve, mungesa e shkollave, mungesa e shërbimit shëndetësor që këtu nuk u prek dhe një qytetar nuk e le fëmijën e tij të pashkolluar dhe nuk e le të pakuruar dhe normal do lëviz. Shton këtu pastaj zhvillimin ekonomik, gjetjen e punës dhe elementët e tjerë që e shtojnë. Do ishte fat për ne, në qoftë se përgjatë këtyre viteve shqiptarët do kishin lëvizur në mënyrë kaq natyrale, në formë migratore. Jo, humbjet janë emigratore dhe pa kthim dhe u dëgjua dhe këtu, meqë po mbie rasti të kundërshtoj, u dëgjua këtu që kanë ardhur banorë, sa është numri i banorëve që është kthyer. Tani, dhënat nuk e dëshmojnë, Istatin nuk e dëshmon një gjë të tillë, dhënat e studimeve të organizatave ndërkombëtare nuk e dëshmojnë dhe sot tendenca për t'u larguar nga Shqipëria është në rritje, se e tregojnë dhënat. Mos bëjmë lojë shifrash, domethënë duke mos pasqyruar dhe cilësinë e atyre shifrave. Faleminderit!

### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit, duke falënderuar kryetarët e Bashkisë së Qarkut të Kukës dhe një moment të caktuar, shpresoj që t'i bashkohemi të gjithë bashkë ftesës së z. Biberit për të vizituar Tropojën dhe për të bërë një diskutim atje. Do ta mbyllja këtë seancë, të marrim një 10 minuta të shkurtra pushim sa për të marrë frymën dhe të fillojmë tjetrën. Po, znj. Tabaku, më falni.

### **Jorida Tabaku:**

Po, të nderuar kolegë, duke qenë se jemi drejt finalizimit edhe të dëgjesave, unë kam një propozim për procedurë. Për Bashkinë e Tiranës, ne kemi propozuar një dëgjesë për qytetin e Tiranës, por njëkohësisht besoj do kemi dhe këtu përfaqësues të bashkisë kur ta zgjidhim se kush është kryetari. Unë do të propozoja në fakt që ne të kishim disa dëgjesa edhe për komunat. Propozimi im është si më poshtë vijon: për zonën e Petrelës, Petrelë, Baldushkë, Bërzit, Krabë dhe disa prej fshatrave rreth e rrotull; për zonën e Dajtit, që prek pjesën e Shëngjergjit, Zallbastarit, Zallherit; për pjesën e Ndroqit, ku është Ndroqi Peza Avaqari dhe njëkohësisht për zonën e Kasharit dhe ish-komunën Bërzull. Unë, në fakt, duke qenë se jam dhe deputete e Qarkut të Tiranës, kërkesa më e madhe që kam nga qytetarët e këtyre komunave është që të dëgjohen. Se si do jetë vendimi, ne nuk e dimë, por e rëndësishme është që ne këto qytetarë t'i dëgjojmë, sepse një pjesë e këtyre ish-komunave, njërive administrative, kanë numër banorësh më të madh se një prej qarqeve ose qyteteve të reja. Kështu që, zoti Mazniku, në qoftë se është e nevojshme, ne këtë kërkesë e bëjmë zyrtarisht edhe nga banorët e tyre. Ka kërkesa nga banorët, mund ta bëjmë në një formë më të thjeshtë sesa dëgjesat e mëdhaja, por dua t'ju kërkoj që ne t'i dëgjojmë banorët e qytetit të Tiranës. Faleminderit!

### **Arbjan Mazniku:**

Propozimi im për këtë çështje, që e kam thënë dhe përpara, e rithem sërish, është që ne nuk ka nevojë që të kemi një axhendë të vetme të komisionit, që do të thotë axhenda formale e takimeve të mëdha, këto që bëjmë tani. Mund të kemi shumë thjeshtësisht një axhendë paralele, në të cilën dy apo katër anëtarë të komisionit, që nuk ka nevojë të jetë ti e mundur apo zoti Boçi, por dy anëtarë të tjerë të komisionit që kanë më shumë interes në një zonë të caktuar, bashkë me dy ekspertë apo katër ekspertë bashkangjitur, mund të zhvillojnë paralelisht me dëgjesat kombëtare dhe dëgjesat në qark, dëgjesat më të vogla në zona më specifike, duke adjustuar axhendat respektive. Po, edhe 2-2 dhe 1-1, domethënë është krejt normale. Ne sigurojmë që të ketë ekspertë nga dy palët, që të mbajnë dhe një shënim me protokoll për diskutime për axhendë. Me të njëjtin protokoll që kemi organizuar takimet e qarkut, të organizohen, por investimi i organizimit për të gjithë gjënë e bën ushtrimin nga ana teknike kompleks, ndaj ky është mekanizmi i cili duhet koordinuar mundësitë. Them që nuk ka asnjë problem ta bëjmë, por ama kjo nuk duhet të ndikojë axhendën ekzistuese, sepse.

### **Jorida Tabaku:**

Unë e kuptoj sa e vështirë është që të bëhej ajo axhendë, pa e prekur. Bëhemi fleksibël edhe përshtatemi, i bëjmë pak më të thjeshta, nuk ka rëndësi.

### **Arbjan Mazniku:**

Nga ana e maxhorancës, keni gjithë dakordësinë maksimale, ulemi ta flasim, ta koordinojmë datat dhe vendet dhe patjetër.

### **Jorida Tabaku:**

Rëndësi ka që ato qytetarë të dëgjohen. Faleminderit!

